

## PREZANTIMI I AVANCUAR

**ECDL / ICDL Prezantimi i Avancuar është një program certifikues për kandidatët që dëshirojnë të krijojnë prezantime me efekte dhe ndikim të lartë, duke përdorur karakteristika të avancuara dhe që janë në gjendje të provojnë aftësitë e tyre në këtë fushë. ECDL / ICDL certifikata për programin e avancuar për prezantime përfshin karakteristika të avancuara që do të ju mundësojnë juve përdorimin e plotë të aplikacioneve të prezantimit.**

**Kandidatët të cilët i kanë certifikuar aftësitë me ECDL / ICDL programin e avancuar për prezantime mund të:**

- Planifikojnë dhe dizajnojnë prezantime shumë efektive me ndikim të madh.
- Përdorin karakteristika të avancuara për të rregulluar strukturën dhe pamjen
- Përdorin dhe manipulojnë fotografitë, imazhet, objektet e vizatuara dhe diagramet në prezantime
- Përfshijnë elemente të sofistikuara multimediale në prezantime
- Shfrytëzojnë mjete të fuqishme për lidhjen e informacionit me aplikacionet e tjera

**Udhëzimet për këtë modul sugjerojnë 30 orë mësim para se kandidati t'i nënshtrohet testimit.**

### KUJT I DEDIKOHET KY MODUL?

Kandidatët e ardhshëm potencial duhet të kenë certifikimin ECDL / ICDL dhe / ose përvojë të mëparshme të përdorimit të kompjuterëve dhe aplikacioneve softuerike. Në mënyrë të veçantë, këta do të jenë individë të cilët përdorin një gamë të gjerë të funksioneve të avancuara brenda një aplikacioni për prezantim të avancuar si për përdorim personal ashtu edhe atë profesional. Prezantimet e suksesshme kërkojnë përmbajtje të zhvilluar mirë dhe me ndikim të lartë e të shoqëruar me një shpërndarje të sofistikuar. Aplikacionet e prezantimit janë një mjet kyç në këtë proces dhe janë më të efektshme kur përdoruesit kanë aftësi për t'i shfrytëzuar ato plotësisht. Certifikimi me modulën e ECDL-se për programin e avancuar të prezantimeve i mundëson kandidatëve zhvillimin dhe demonstrimin e shkathtësive të tyre duke përdorur vegla të avancuara që janë në dispozicion në aplikacionet standarde të prezantimit dhe të krijojnë prezantime profesionale dhe me ndikim të lartë për të mbështetur komunikimin efektiv. Për të mësuar më shumë në lidhje me këtë modul mësimor dhe materialeve trajnuese si dhe për të gjetur qendrën tuaj më të afërt të akredituar, ju lutemi vizitoni [www.ecdl-kosova.org](http://www.ecdl-kosova.org)

FILLO

RRITU

NDËRTO

AVANCO

VAZHDO

**Certifikatat e lëshuara nga ECDL Kosova vlejnë ndërkombëtarisht.**